



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:175341  
Datë: 13.12.2024  
Numri i dokumentit: 06592496

Pml.nr.655/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Agim Maliqi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit N. M., nga fshati ..., komuna e V., për shkak të veprës penale: “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, nga neni 267, paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës të Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, 2020:175341, të datës 24.05.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.421/2023, të datës 06.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 05.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit N. M., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, 2020:175341, të datës 24.05.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.421/2023, të datës 06.09.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, 2020:175341, të datës 24.04.2023 (pika I. e dispozitivit), i dënuari N. M., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale: “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, nga neni 267, paragrafi 1 të KPRK-së dhe ndaj të njëjtit është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vjetëve dhe dënim me gjobë në shumë prej një (1.000) euro, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

Nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve, pasi aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, atëherë gjykata dënimin me gjobë do t'ia zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që për çdo njëzetë (20) euro të papaguara do të llogaritet një (1) ditë burgim.

Konform nenit 267, paragrafi 5 të KPRK-së, është konfiskuar në mënyrë të përhershme substanca narkotike e llojit "Heroinë", me peshë të përgjithshme prej 99.05 gram.

Është detyruar i dënuari N. M., që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Ndërsa, me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë (pika II. e dispozitivit), konform nenit 363, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), i akuzuari B. R., është liruar nga akuza për shkak të veprës penale "Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge", nga neni 269, paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin e PAKR.nr.421/2023, e datës 06.09.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Ferizaj dhe të mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit N. M., avokati Ymer Huruglica, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7. dhe paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7. lidhur me nenin 369, paragrafët 6, 7 dhe 8, si dhe nenit 360 të KPP-së, duke përfshirë edhe nenin 123, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPP-së dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal, nga neni 385 të KPP-së, duke i propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës që kërkesën ta aprovon, ndërsa aktgjykimet e kundërshtuara t'i ndryshon, ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza apo këto aktgjykime t'i anulon, ashtu që çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.378/2024, e datës 28.10.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, si dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe përgjigjen në kërkesë të Kryeprokurorit të Shtetit, gjeti se:

- kërkesa është e pabazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit, në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkeljet e lartcekura, duke e kontestuar në radhë të pare, kompetencën e gjykatës së shkallës së parë për gjykimin e kësaj çështje penale në raport me të dënuarin N. M., pasi që vepra penale për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor i njejtë sipas pikës I. të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë konstatohet se është kryer në fshatin ..., komuna e V., e që bie në kompetencë të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, ndërsa këtë aktgjykim e ka marrë Gjykata Themelore në Ferizaj, përkatësisht i njejtë department, si gjykatë jo kompetente.

Mandej, mbrojtësi i të dënuarit e konteston edhe çështjen e konfiskimit të substancës narkotike me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke shtuar se nga shkresat e lëndës, e në veçanti nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të lëshuar nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve në Gjilan, me numër 2020-DHTN-533, i datës 09.11.2020, vërtetohet se substanca e lartcekur narkotike është sekuestruar nga A. M., e jo nga i dënuari N. M., provë kjo që e kundërshton, jo vetëm pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit, por edhe nga provat tjera materiale, nuk vërtetohet se nga i dënuari të jetë sekuestruar as edhe një gram i vetëm substancë narkotike, andaj edhe nuk ka logjikë që të konfiskohet kjo sasi e narkotikëve, kur nga i dënuari nuk është sekuestruar asnjëherë më parë një substancë e tillë.

Gjithashtu, mbrojtësi i të dënuarit pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë bazuar në prova të papranueshme, duke ju referuar këtu deklarimeve të dëshmitarëve: M. S. dhe A. M., të cilët e kanë edhe cilësinë e të pandehurve në lidhje me rastin e njejtë që është zhvilluar në Gjykatën Themelore në Gjilan, për të cilën veprë penale edhe janë shpallur fajtor.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikoi shkresat e lëndës dhe analizoi pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit, konstatoi se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, nuk janë të përfshira me ndonjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se si aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë janë përpiluar në formën e parashikuar me ligj, pasi që përmbajnë të gjitha elementet që kërkohen sipas nenit 369 dhe nenit 404, paragrafi 1 të KPP-së, si në pjesën e dispozitivit, ashtu edhe në pjesën e arsytimit.

Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se dispozitivi i këtyre aktgjykimeve është i qartë, nuk është në kundërshtim me vetveten dhe është në harmoni me arsytimin e tyre, kurse në arsytimet e tyre janë paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha çështjet e rëndësishme.

Në këtë mënyrë, rezulton se në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme të gjitha rrethanat dhe faktet të cilat i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të figurës së veprës penale për të cilën është shpall fajtor i dënuari N. M., ndërsa është e rëndësishme që të theksohet se të

gjitha këto rrethana gjejnë mbështetje edhe në provat e administruara gjatë shqyrtimin gjyqësor, në veçanti nga deklaratat e dëshmitarit M. R., transkriptet e bisedave telefonike në mes të dënuarit N. H., me dëshmitarin A. M., foto dokumentacionin, raportet e këqyrjes së vendit të ngjarjes, raportin e ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, si dhe provat tjera materiale që gjenden në shkresa të lëndës.

Përveç tjerash, përmes aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rezultojnë se gjykata në fjalë ka përmbushur edhe detyrimet e saj për të paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta sa i përket të gjitha pikave të rëndësishme, referuar nenit 369, paragrafëve 6, 7 dhe 8 të KPP-së.

Në këtë drejtim, nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet që janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh janë konsideruar të vërtetuara, janë vlerësuar dhe analizuar në mënyrën e duhur të gjitha provat e administruara, si dhe janë paraqitur arsyet në të cilat, gjykata në fjalë është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të dënuarit N. M.

Po ashtu, në drejtim të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i dënuari në fjalë, në arsyetimin e këtij aktgjykimi shihet që janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta edhe sa i përket rrethanave, si lehtësuese, ashtu edhe rënduese, që gjykata në fjalë i ka marrë për bazë e rastin e caktimit të dënimeve. Në këtë pjesë të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar mjaftueshëm disa rrethana lehtësuese dhe rënduese, në mesin e tyre, edhe të kaluarën penale të të dënuarit N. M., nga e cila shihet që i njëjti edhe më parë kishte qenë i dënuar për vepra penale të natyrës së tillë dhe atë sipas tre (3) aktgjykimeve të specifikuar të Gjykatës Themelore në Gjilan.

Edhe pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit në lidhje me mungesën e kompetencës së gjykatës së shkallës së parë, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës është i pabazuar. Edhe pse mbrojtësi i referohet nenit 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7. të KPP-së, dispozitë ligjore kjo që ndërlidhet me mungesën e kompetencës lëndore për të gjykuar çështjen, nga përmbajtja e kërkesës rezultojnë që kontestohet kompetenca territoriale, e jo kompetenca lëndore e gjykatës së shkallës së parë.

Sidoqoftë, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se nuk bëhet fjalë për shkelje ligjore në këtë drejtim, pavarësisht faktit se vepra penale është kryer në fshatin ..., komuna e V., territor ky që bie në kompetencë të Gjykatës Themelore në Gjilan, ndërsa është gjykuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, për faktin se nga shkresat e lëndës shihet që në këtë rast është iniciuar një procedurë e bashkuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj ndaj disa të akuzuarve, për vepra penale që ndërlidhen me narkotikë, ku veprat penale kanë qenë të ndërlidhura dhe gjithashtu provat kanë qenë të përbashkëta, ashtu siç parashihet në nenin 34, paragrafët 6 - 9 të KPP-së.

Përndryshe, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se bazuar në nenin 37, paragrafi 2 të KPP-së, pasi aktakuza të konfirmohet (neni 249, paragrafi 1 i KPP-së), gjykata nuk mund të shpall veten jo kompetente në pikëpamje territoriale dhe palët nuk mund të paraqesin kundërshtime për shkak të mungesës së kompetencës territoriale.

Edhe pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit në lidhje me konfiskimin e substancës narkotike vlerësohet si i pabazuar, për shkak se me aktgjykimet e kundërshtuara është arsyetuar mjaftueshëm se substancën narkotike që është konfiskuar, personi i quajtur A. M., paraprakisht e kishte marrë nga i dënuari N. M., në garazhin e shtëpisë së këtij të fundit, e që një gjë e tillë është argumentuar, në radhë të parë nga transkriptet e bisedave telefonike të zhvilluara në mes të të dënuarit N. M., me personin e quajtur A. M., por edhe nga provat tjera që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, siç janë: deklaratimet e dëshmitarit: M. R., si dhe nga provat përkatëse materiale. Andaj, edhe nuk ka kurrfarë relevance, fakti që substanca narkotike është sekuestruar nga personi i quajtur A. M., por që është konfiskuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë me të cilin është shpallur fajtor i dënuari N. M., pasi që i njëjti paraprakisht e kishte patur në posedim këtë sasi të substancës narkotike, me të cilin më pastaj e kishte furnizuar personin e quajtur A. M.

Gjithashtu, Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron si të pabazuar edhe pretendimin se aktgjykimet e kundërshtuara janë të bazuara në prova të papranueshme, pasi që prova vendimtare mbi bazën e të cilave është bazuar fajësia e të dënuarit N. M., kanë qenë në radhë të parë deklaratat e dëshmitarit M. R., transkriptet e bisedave telefonike në mes të dënuarit N. H., me dëshmitarin A. M., foto dokumentacioni, raportet e këqyrjes së vendit të ngjarjes, raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, si dhe provat tjera materiale që gjenden në shkresa të lëndës, ndërsa të gjitha këto prova rezulton se janë siguruar dhe administruar në mënyrën e parashikuar me ligj, kështu që nuk mund të konsiderohen si prova të papranueshme. Në anën tjetër, deklaratat e dëshmitarëve: A. M., dhe M. S., pavarësisht faktit që vërtetojnë disa aspekte të rëndësishme që ndërlidhen me përgjegjësinë penale të të dënuarit N. M., të njëjtat nuk janë deklarata vendimtare mbi bazën e të cilave është vendosur kjo çështje penale.

Në fund, edhe pse kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur edhe për shkak të shkeljes së ligjit penal nga neni 385 të KPP-së, mbrojtja nuk ka përcaktuar konkretisht se ku qëndrojnë këto shkelje dhe cilat dispozitat ligjore janë shkelur, ndërsa në anën tjetër, Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka vërejtur ndonjë shkelje të natyrës së tillë, siç është theksuar edhe më lart.

Andaj, edhe nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar dhe pajtim me dispozitën ligjore të nenit 437 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.655/2024, më datë 05.12.2024

Procesmbajtës,  
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,  
Valdete Daka